



N. Prot. 367

Tiranë, më 17/8/2023

**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PRANIMIN NË MASTERIN EKZEKUTIV
NË**

“International Master Degree on Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage”

VITI AKADEMIK 2023-2024

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Universiteti i Firences, Universiteti Katolik ZKM dhe Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës në përputhje me legjislacionin Universitar Shqiptar dhe Italian në fuqi në vendet respektive, për vitin akademik 2023-2024, hapin Masterin Ekzekutiv të Nivelit II, ***“International Master Degree on Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage”***.

Për vitin akademik 2023-2024, në masterin “International Master Degree on Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage”, numri maksimal i studentëve për pranuar është 35. Në rast se knumri i aplikantëve është më i lartë se numri i kuotave të parashikuara, përzgjedhja do të bëhet mbi bazën e CV-së dhe testeve të mëvonshme me shkrim dhe me gojë.

OBJEKTIVAT FORMUES

Objektivi i Masterit është të formojë arkitektë të specializuar në sektorin e restaurimit të trashëgimisë kulturore, teknikë të specializuar në projektin e restaurimit të ndërtesave historike, duke hapur linja të reja pune në sektorin e ndërtimit. Integrimi mes kulturës italiane dhe asaj shqiptare ka si qëllim formimin e teknikëve të trajnuar që punojnë në zonën e Mesdheut duke ndarë objektivat dhe trajnimin.

KUSHTET PËR PRANIM

Pranimi në Master është i hapur në mënyrë kryesore për:

- A. Të diplomuarit në Itali të cilët duhet të kenë një diplomë Master i Shkencave në përputhje me Dekretin e Ministrisë 270/2004 e klasifikuar si më poshtë (ose në bazë të Dekretit të Ministrisë 509/1999 në një nga klasat e mëposhtme ose sistemet e mëparshme respektive në përputhje me Dekretin Ndërmnistor të datës 9 korrik 2009):
 - Arkeologji,
 - Arkitekturë e peizazhit,
 - Arkitekturë dhe inxhinieri ndërtimi,
 - Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit,
 - Shkenca për Ruajtjen dhe Restaurimin e Trashëgimisë Kulturore,
 - Inxhinieri për mjedisin dhe territorin,
 - Inxhinieri civile,
 - Inxhinieri e sistemeve të ndërtimit,
 - Planifikim territorial dhe mjedisi
- B. Të diplomuarit në Shqipëri dhe në vende të tjera, është e nevojshme të jenë zotërues të titujve të barasvlefshëm si në pikën A dhe të kenë përfunduar studimet dhe të kenë diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë të një programi studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave",



i autorizuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin kur studentit diplomohet ose, i diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” ose në një program studimi të ciklit të dytë, të autorizuar dhe të akredituar. Nëse pranohet, kandidati është i detyruar të bëjë njehsimin e diplomës në QSHA.

HAPËSIRAT E PUNËSIMIT

Masteri synon të formojë profesionistë me njohuri, aftësi dhe kompetenca teknike-profesionale të një lloji ndërdisiplinor dhe multidisiplinor, të nevojshme për identifikimin, restaurimin, ruajtjen, menaxhimin, rritjen dhe komunikimin e trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore.

MËSIMDHËNIA

Masteri promovon një qasje ndërdisiplinore, e cila reflektohet në organizimin e programit në module tematike në prezencë, me në total 60 ECTS: 1. Trashëgimia materiale dhe jomateriale dhe diversiteti; 2. Mjetet për dokumentimin, diagnostikimin, menaxhimin dhe komunikimin e trashëgimisë; 3. Metodologjitë dhe teknikat e restaurimit dhe ruajtjes; 4. Trashëgimia, rreziku, ndryshimet klimatike dhe elasticiteti; 5. Menaxhimi i Siteve për Listën e Trashëgimisë Botërore. Parashikohet një praktikë prej 150 orësh në organizatat dhe strukturat që veprojnë në zonat operative të masterit. Programi përfundon me mbrojtjen e një teme kërkimore.

PROVIMI PËRFUNDIMTAR

Ky master u mundëson të gjithë studentëve të regjistruar të kuptojnë kompleksitetin e procesit që nevojitet për të zhvilluar projektin e restaurimit, duke garantuar një vizion ndërkombëtar të disiplinës. Masteri përfundon me përpunimin e një Projekti Përfundimtar të Programit të studimit i cili do të duhet të marrë parasysh atë që është mësuar në modulet e ndryshme.

- Në sistemin e arsimit të lartë italian, titulli i dhënë është “*Master i Nivelit të Dytë*” dhe për pranimin në të kërkohet një titull studimi i ciklit të dytë sipas procesit të Bolonjës.
- Në sistemin e arsimit të lartë shqiptar, titulli i dhënë është “*Master Ekzekutiv*” dhe për pranimin në të kërkohet një titull studimi i ciklit të dytë.

Përfundimi i masterit nuk mundëson aksesin në ciklin e tretë të procesit të Bolonjës (Doktoratë dhe/ose Shkollat e Specializimit).

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Për të aplikuar për pranim, kandidatët duhet të plotësojnë procedurën e regjistrimit *online* në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> **deri më 04 tetor 2023, ora 23.59**, duke bashkëlidhur një kopje elektronike në formatin PDF (skanim pdf/A) të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a. Diplomë universitare.
- b. Certifikata e diplomës e lëshuar nga Universiteti i origjinës;
- c. Certifikatë e Diplomës së Maturës/Lista e notave;
- d. Tituj të tjerë të mundshëm të vlefshëm (kurse formimi dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, PhD)
- e. Curriculum Vitae në gjuhën italiane.
- f. Certifikatë¹ Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe në përputhje me Dekretet e Ministrisë në fuqi;
- g. Dokument identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti).

¹Për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), diploma do të përmbushë këtë kusht dhe kandidatët do të përjashtohen nga detyrimi për të dhënë Certifikatën e njohjes e gjuhës së huaj në zbatim të përcaktimeve të paragrafit 4 të nenit 76 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Kandidatët e huaj, pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më sipër, do të duhet të kryejnë gjithashtu **deri më 04 tetor 2023**, pagesën e tarifës prej 50 euro për aplikimin² si në vijim:

- me transfertë bankare³ me koordinatat e mëposhtme:

Përfitues: Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

Banka: Intesa San Paolo Bank

BIC/Swift: USELALTR

IBAN: AL60208112040000030694935302

- me kartë krediti online në portalin universitar: <http://admissions.unizkm.al/>;

- me para në dorë në Zyrën e Pranimeve të Universitetit të disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00 deri në 16:30.

Në vijim do të kontrollohen dokumentet për secilin kandidat. Statusi i regjistrimit tuaj mund të kontrollohet duke hyrë në zonën personale të rezervuar në portalin e Universitetit.

Kandidatët të cilët, pas verifikimit të dokumentacionit konsiderohen të përshtatshëm, duhet të paguajnë edhe tarifën e intervistës brenda datës **12 tetor 2023, ora 16:30**:

- 2000 lekë për kandidatët shqiptarë dhe shtetas të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi;
- 100 euro për kandidatët e tjerë të huaj.

Pagesa bëhet duke përdorur të njëjtat mënyra të përdorura për pagesën e tarifës prej 50 euro.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kandidatëve për Masterin Ekzekutiv të Nivelit II, “International Master Degree on Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage” do të bëhet përmes një interviste në gjuhën italiane e cila do të zhvillohet në datën 13 tetor 2023, në orën 11:00 në selinë e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Rr. “Dritan Hoxha” Tiranë, Shqipëri.

Rezultatet e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik NSBC: <https://www.unizkm.al/> deri më **16 tetor 2023**.

REGJISTRIMI

Për regjistrimin, kandidatët e shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të disponueshme, duhet të dorëzojnë në Sekretarinë Mësimore, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur me autorizim, **deri më 27 tetor 2023** dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vërtetimin e pagesës bankare (mandatpagesa mund të shkarkohet nga portali i studentëve të universitetit: <portal.unizkm.al>, artikulli: Tarifat);
2. Diplomë, ose kopje e njehsuar me origjinalin, e ciklit II të studimeve "Master i shkencave" / "Master i arteve" përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diploma e ciklit të dytë të studimeve të kryera jashtë vendit, e pajisur me kopje të njehsuar të origjinalit të diplomës, ose nëse nuk disponohet, një dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njehsimi në Republikën e Shqipërisë, i lëshuar në shteti në të cilin ka kryer studimet, gjë që i mundëson regjistrimin dhe vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve në vendin përkatës.

Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një universitet i huaj, ai duhet të ketë vulën Apostille.

²Çdo komision i ngarkohet porositisit. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, me dënim të pavlefshmërisë së regjistrimit.

³Ju lutemi specifikoni emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin (et) e studimit për të cilin po paguani në Urdhërpagesë. Në ditën e testimit është e nevojshme të paraqitet një kopje e urdhërpagesës pasi koha e akreditimit është e kufizuar.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

3. Vërtetim për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, nga testime të njohura ndërkombëtarisht. Nëse kandidati ka një diplomë nga një program studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e marrë shërben si certifikatë për të përmbushur këtë kusht.
4. Kopje e dokumentit të identitetit (kartë identiteti/pasaportë);
5. Dy foto personale.
6. Curriculum vitae i shkruar në italisht.
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e librezës së punës.
8. Certifikata Mjekësore i Aftë për punë;
9. Vërtetim i vendbanimit;
10. Certifikatë familjare;
11. Për shtetasit e huaj, nevojitet certifikata e njohurive gjuhësore të gjuhës shqipe, e lëshuar nga strukturat përkatëse kur dëshirojnë të regjistrohen në një program studimi të kryer në gjuhën shqipe. Shtetasit e huaj me kombësi shqiptare dhe njohuri të mira të gjuhës shqipe, mund të paraqesin çdo dokument të lëshuar në vendin e tyre të origjinës që vërteton njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen edhe shtetasit e huajt që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe pranë institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri.
12. Dokumenti i njehsimit⁴ të diplomës lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë, në origjinal ose kopje të vërtetuar (vetëm për kandidatët që kanë marrë diplomën jashtë vendit dhe për ata që kanë marrë tashmë dokumentin e njehsimit nga Qendra e sipërpërmendur). Për ata që nuk janë pajisur me dokumentin e Njehsimit, sipas Urdhrit të Përbashkët Nr. 13 datë 30.06.2023 ekziston detyrimi për paraqitjen e një dokumenti të tillë **deri më 30 mars 2024**.
13. Çdo kualifikim i vlerësueshëm (kurse formimi dhe specializimi, kurse gjuhësore, Master, PhD);

Në Sekretarinë Mësimore do të plotësohen gjithashtu sa më poshtë:

- Aplikimi për regjistrim (shkarkohet edhe nga Portali Studentor: portal.unizkm.al);
- Formulari sipas Shtojcës n. 2 të Dekretit të Ministrisë nr. 12 datë 30.06.2023.
- Deklarata sipas Shtojcës nr. 1 të Dekretit të Ministrisë nr. 12 datë 30.06.2023.
- Kontrata e regjistrimit.

Kandidatët me diplomë të huaj do të regjistrohen me kusht në Masterin **Ekzekutiv të Nivelit të II**, “*International Master Degree on Restoration, Conservation and Management of Architectural Heritage*” pasi u kërkohet të kenë diplomën përkatëse të njohur dhe të njehsuar deri më **30 mars 2023**.

Shënim: Ju lutemi vini re se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh për semestër (semestri llogaritet nga dita e hyrjes për herë të parë në vend dhe 90 ditët llogariten duke mbledhur të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, qoftë edhe të njëpasnjëshme). Kushdo që synon të qëndrojë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një periudhë gjashtëmujore duhet të aplikojë pranë autoriteteve kompetente shqiptare për një leje qëndrimi.

Rektori
Prof. Leonardo Palombi



⁴Informacioni mbi mënyrën e marrjes së dokumentit të njehsimit të diplomës së studimeve universitare të kryera më parë gjendet në faqen e internetit: <https://unizkm.al/>